

## **Rrënjë dhe degë të krishterimit ndër shqiptarë**

- I. Mjedisi etnik-kulturor
  1. a. Shqiptarët në analet e historisë së krishterimit
  - b. Krishterimi në arealin kulturor shqiptar deri në shfaqjen e bashkësisë etnike shqipfolëse në historinë e Ballkanit
  2. Faktorë ndërveprues
    - a. Pozita gjeografike e këtij areali si hapësirë jetike kompakte e bashkësisë etnike shqipfolëse
    - b. Gjendja historike-sociale, e kushtëzuar prej marrëdhënieve ndëretnike
    - b. Ndikimet kulturore
    - c. Organizimi administrativ i kishës
  - 2.a/b Mjedisi gjeografik-kulturor
    - Kufijtë e hapësirës jetike shqipfolëse
    - Simbiozë kulturash: Adriatiku dhe Ballkani
  - 2.a/c Pozicioni gjeografik: kufi dhe urë lidhëse ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit
  - 2/d Rrethanat kishtare
    - Fillimet e misionimit kristian
    - Organizimi i hershëm administrativ kishtar (deri në shek. VI-VII)
      - o Shkatërrimi i administratës kishtare (shek. VII-VIII)
      - o Dyndjet dhe ngulimet e sllavëve të jugut në Ballkan
      - o Rimëkëmbja dhe riorganizimi i klerit dhe i administratës kishtare
  3. Shqipëria dhe shqiptarët pas skizmës (1054 – 1453)
    - a) Marrëdhëniet fetare: kufijtë gjeografikë të konfesioneve
    - b) Marrëdhëniet kulturore-ndëretnike
- II. Prehistoria e krishterimit ndër shqiptarë parë nga perspektiva e etnolinguistikës
  4. Terminologjia kristiane dhe emrat e shenjtorëve si material burimor i dorës së parë
    - Rëndësia e përpunimit filologjik të teksteve të letërsisë së vjetër shqipe (shek. XVI-XVIII)
    - Forca dëshmuese e shtresimit të leksikut kishtar
      - a) Shtresa latine (deri në shek. VI-VIII)

- b) Shtresa romane: italianizmat (e vjetra), dalmatizmat (shek. VIII-IX)
- c) Shtresa greke: huazime prej greqishte e mesme dhe e re
- d) Shtresa autoktone
- e) Shqiptarët dhe sllavët

### III. Përfundime

#### I. Mjedisi etnik-kulturor

1.a Një shkrim me titull të tillë e me autor një studiues të gjuhës shqipe mund të hedhë te shumëkush dyshime në origjinalitetin e tij. Megjithatë është fakt që gjatë hetimit dhe përshkrimit të detajuar të këtij përbërësi aspak dytësor në matriksin e kulturës etnike shqiptare janë parë e gjykuar gjithherë të mirëseardhura edhe përpjekjet brenda disiplinës sonë. E këto kanë të bëjnë së pari, por jo vetëm atë, me përpunimin filologjik të trashëgimisë së kulturës së shkrimit shqip, në të cilën prej fillimeve të saj e deri aty nga fundi i shek. XVIII feksin shkrimet me karakter teologjik, liturgjik dhe katekistik kristian (Buzuku 1555, Matranga 1592, Budi 1618, 1621, Kazazi 1743 etj.), apo asish që janë në funksion të tyre (Bardhi 1635, Bogdani 1685, Da Lecce 1702, 1716, Kuvendi i Arbënit 1706, Jul Variboba 1762 etj.). Terminologjia e krishterë, festat fetare dhe emrat e shenjtoreve, të cilët në këto shkrime gëzojnë kryesisht forma të ligjërit popullor, përforcojnë dukshëm fondin e dëshmime burimore, më se të nevojshme në hetimin me sukses të fazave të hershme të krishterimit ndër shqiptarë deri në shfaqjen e tyre në analet zyrtare të historisë së Ballkanit në shek. XI – XIV si një bashkësi etnike e kristianizuar.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> *Michaelis Attaliothae historia*, hg. W. Brunet überarbeitet von I. Bekker. Bonn 1853; shih më hollësisht shën. 14. Khs. gjithashtu: "Anonymi Descriptio Europae Orientalis" (1308 A. D.): "... Duas tamen constat esse Albanias, unam in Asia que est circa Indiam et de illa non loquimur hic, aliam in Europa, que est de imperio constantinopolitano et de hac loquimur hic. Duas provincias continet in se, videlicet Clisaram et Tumorist. Prefer has duas provincias habet juxta se et alias provincias, videlicet Cumaniam, Stophanatum, Palatum, Debre que quidem provincie sunt tributarie eisdem Albanensibus et quasi serve, quia exercent agriculturam et colunt vineas ipso rum ac servant necessaria in domibus suis. Homines istarum provinciarum non moventur de loco ad locum, sicut prefati Albanenses, sed habent stabiles mansiones et opida, nee sunt pure catholici, nee pure scismatici. Si tamen esset, qui eis verbum dei proponeret, e/ficerentur puri catholici, quia naturaliter diligunt Latinos ut dictum est. Habent enim Albani prefati linguam distinctam a Latinis, Grecis et Sclavis ita quod in nullo se inteligunt cum aliis nationibus, ..." me përkthimin në anglisht: "There are two Albanias, one in Asia near India of which we are not speaking here, and the other in Europe which is part of the Byzantine Empire and of which we are speaking here. It contains two provinces: Clisara and Tumorist. In addition to these two provinces, it has other provinces next to it: Cumania, Stophanatum, Polatum, and Debre which are provinces tributary to the Albanians and more or less subjected to them, for they are active in farming, tend their vineyards and take care of the necessities of life at home. The inhabitants of these provinces do not move from

1.b Kjo periudhë përshkruhet me stil të thukët prej historianit gjerman Georg Stadtmüller, si vijon:

„Zona bregdetare e romanizuar në Shqipërinë e sotme (provincat romake Prevalitania, Epiri i Ri dhe i Vjetër) u kristianizua në shek. IV dhe V prej Dalmacisë së Jugut (me metropoli Salona-n). Në rrjedhën e shek. V krishterimi depërtoi edhe në trevat malore. Para pushtimit sllav (rreth viteve 600 AD) në trevat e Shqipërisë së sotme gjëllinte metropolia e Shkodrës me disa ipeshkvi. Pushtimi sllav shkaktoi një kthesë të fuqishme prapa: luginat shqiptare dhe zona bregdetare u shndërruan në treva të ngulimeve sllave, fshatarësia e romanizuar u shpërngul, organizimi kishtar u rrëgjua, ndërkohë që një pjesë e protoshqiptarëve me prejardhje ilire, që jetonin në malësi dhe që i kishte rrokur vetëm pjesërisht procesi i romanizimit, u zhytën në paganizëm, duke përjetuar gjatë shek. VII deri XI një jetë thuajse pa histori.”<sup>2</sup>

## 2. Faktorë ndërveprues

Nga kjo paraqitje e thukët e gjithë periudhës në fjalë mësojmë se procesi i kristianizimit ndër shqiptarë është kushtëzuar nga disa faktorë objektivë dhe subjektivë, ndër të cilët dallojmë:

- a. pozitën gjeografike të zonës në fjalë, përkatësisht të hapësirës jetike të shqiptarëve që rezulton prej saj,
- b. rrethanat historike-sociale që kushtëzuan marrëdhëniet e ndryshme ndëretnike,
- c. ndikimet kulturore,
- d. organizimin e Kishës si institucion i kultit fetar.

Le të ndalemi në vijim shkurt në secilin ndër këta faktorë, duke u

---

place to place as the aforementioned Albanians do, but live rather in solid mansions and towns, nor are they entirely Catholic or entirely schismatic. Should anyone preach the word of God to them, they would pretend to be true Catholics for it is reported that by nature they have a liking for the Latins. The aforementioned Albanians have a language which is distinct from that of the Latins, Greeks and Slavs such that in no way can they communicate with other peoples.” (Elsie 1990 26v.)

2 Theologische Realenzyklopädie (2, 1978): “Das romanisierte Küstenland des heutigen Albaniens (römische Provinzen Praevalis, Epirus Nova und Vetus) wurde im 4. und 5. Jh. von Süddalmatien (Metropole Salona) aus christianisiert. Im Verlaufe des 5. Jh. drang dann die Christianisierung auch in die Berglandschaften vor. Vor der slawischen Landnahme (um 600 n.Chr.) gab es im Gebiet des heutigen Albaniens die Metropole Scodra (Skutari) und mehrere Bistümer. Die slawische Landnahme brachte einen großen Rückschlag: die albanischen Flusstäler und Küstengebiete wurden zu slawischem Siedlungsboden, das romanisierte Bauerntum wurde verdrängt, die kirchliche Organisation vernichtet, während die in den Gebirgen lebenden, von der Romanisierung nur teilweise erfassten, von den Illyriern abstammenden Uralbaner zum Teil wieder in das Heidentum zurücksanken und zwischen dem 7. und dem 11. Jh. ein fast geschichtsloses Leben führten.”

përqendruar sipas rastit në ato argumente që gjejnë mbështetje kryesisht në metodat e studimit gjuhësor.

2.a Dy konstante gjeografike kanë kushtëzuar përgjatë gjithë kësaj periudhe rrjedhën e zhvillimit ekonomik-social si edhe marrëdhëniet kulturore-ndëretnike në rajon: a) nga njëra anë konfiguracioni i terrenit në këtë zonë, e b) nga ana tjetër pozicioni i saj midis dy qendrave të kulturës evropiane të kohës: Romës dhe Kostandinopojës.

2.a-b Mjedisi gjeografik përshfaq thujtë gëjthkund një bashkëlidhje të pazakontë të konfiguracioneve të terrenit, duke mundësuar kështu një bashkërendim mënyrash jetese nga më të ndryshmet. Zona bregdetare, ultësirat dhe luginat e pëlleshme, që mundësojnë peshkimin, tregtinë dhe ekonominë intensive bujqësore, kanë qenë gjithherë të parat që u janë nënshtruar proceseve të pushtimit, shfarosjes apo shpërnguljeve masive, përkatësisht të ripopullimit dhe/ose asimilimit. Përndryshe mjedisi malor kushtëzon një bazë tjetër sociale-ekonomike. Aty jeton përgjithësisht një popullsi anase, e cila zhvillon dhe ruan më gjatë marrëdhëniet e ekonomisë malore, traditën e jetës farefisnore si edhe vetë gjuhën burimore të bashkësisë. Kjo mënyrë jetese gjëllin ende sot e gjithë ditën në disa zona të thella në malësitë e Veriut dhe të Jugut të Shqipërisë.<sup>3</sup> Jeta kanunore e malësorëve shqiptarë që vijoi të jetë e tillë deri në kohët moderne, përcjell qartas marrëdhëniet e dikurshme farefisnore të bashkësisë etnike shqipfolëse. Shumë domethënë në këtë pikë është vetë fondi i leksikut të shqipes bashkëkohore, ku ndërthuren shtresa të ndryshme huazimesh leksikore, të cilat na dëshmojnë një bashkëjetesë afatgjatë midis kulturës së zonës së Adriatikut dhe asaj të Ballkanit. Kështu p.sh. fusha të tëra të leksikut të shqipes që kanë të bëjnë me ekonominë malore, ndër to: 'blegtoria' me 'përpunimin e qumështit' apo 'bujqësia malore' mbulohen thujtë tërësisht me njësi leksikore të fondit autokton të shqipes,<sup>4</sup> ndërkohë që fusha të tjera, si: 'peshkimi', 'bujqësia fushore', 'jeta urbane' etj. i janë nënshtruar ndikimit të fuqishëm e të vazhdueshëm latin, greko-bizantin, sllavo-jugor e më vonë atij roman e turko-osman.<sup>5</sup>

2.c Të tjera kontraste përftohen, në rast se e kundrojmë këtë zonë nga një tjetër këndvështrim, fillimisht si zonë lidhëse midis Romës dhe Athinës, dy qendrave të kulturës së antikitetit në perandorinë romake; më pas si zonë kufitare ndërmjet Romës dhe Kostandinopojës, d.m.th.

3 Për enklavat arbëreshe në Greqi dhe në Italinë e Jugut shih Jochalas 1971 105v.; Sasse 1991 6v.; së fundi Guzzetta 2008 (drsh. gjysma e parë e shek. XVIII - 1730-4) 31vv.

4 Khs. ndër të tjera njësitë leksikore *dele, dash, dhi, edh, vathë* etj.; *qumësht, djathë, dhallë, hërrë, shteg* etj.; *drithë, elb, thjerrë, shatë, latë* etj. Shih më hollësisht Sh. Demiraj 1988, 1999 *passim*.

5 Khs. ndër të tjera: *peshk, qefull, grep, varkë, rrjetë* etj.; *fushë, parmendë, tërshërë, kalë, qytet, shtëpi, rrugë* etj. Shih më hollësisht Haarmann 1972 4vv.; Svane 1992 10vv. etj.



ndërmjet Perandorisë Romake të Perëndimit dhe Lindjes (: Bizantit); e më tej ndërmjet Perëndimit (evropian) dhe Lindjes (: Perandorisë Osmane).

Këtë zonë e përshkonte dikur mes përmes Via Egnatia, një rrugë lidhëse ndërmjet epiqendrave të kulturës botërore të kohës. Porë nga kjo perspektivë nuk është aspak rastësi që pikërisht këtu të kenë ngulur sinorët e vet kulturat antike greke dhe romake. Në bazë të përhapjes së mbishkrimeve latine dhe greke që njihen deri sot vërejmë se ky kufi përshkon pak a shumë zonën bregdetare në aksin Durrës (Dyrrachium) – Pojan (Apolonia), aty kthen drejt lindjes përgjatë Via Egnatia-s, duke vijuar në liqenin e Ohrit (Lychnidus) dhe të Prespës. Në jug të kësaj vije me shtrirje pak a shumë deri në Korçë (Korica) në lindje dhe Vlorë (Aulona) në perëndim kemi një zonë të përzier, d.m.th. me mbishkrime greke dhe latine.<sup>6</sup>

Do vënë në dukje gjithashtu se ngërthimi i mëvonshëm i gjithë kësaj zone në Perandorinë Romake të Lindjes (Bizantit), pas gjase, nuk solli ndryshime të menjëhershme në marrëdhëniet ndërkulturore ekzistuese e për rrjedhojë edhe në ndikimet gjuhësore, të paktën deri në fillim të shek. VII, kur latinishtja vijonte të funksiononte si gjuhë zyrtare dhe si mjet komunikimi në ushtri.<sup>7</sup>

2.d Kjo zonë u ngërthye qysh herët në organizimin administrativ kishtar, edhe pse fillimet e misionimit, përkatësisht proceset e kristianizimit në fazën e tij të parë mbeten ende për t'u sqaruar për gjithë hapësirën në fjalë. Udhëtimet e Shën Palit, apostullit të paganëve,<sup>8</sup> si edhe disa legjenda martirësh<sup>9</sup> lejojnë të përsiasim praninë e hershme të bashkësive të vogla kristiane në qytet-portet dhe trevat bregdetare të kësaj zone. Dëshmitë e para shkrimore mbi ipeshkëv dhe seli ipeshkvore të kësaj zone datojnë gjithsesi aty nga mesi i shek. IV. Kështu p.sh. përmendet në vitin 344 ipeshkvi Eulalius i Amantias që merr pjesë në Sinodin e Plovdivit (Philipopolis - Bullgari), ndërsa në vitin 381 janë ipeshkvit e qendrave ipeshkvore të Shkodrës (Scodra) dhe të Durrësit që pjesëmarrin në Koncilin e 2-të Ekumenik të Kostandinopojës. Në shek. V dhe VI përmenden gjithnjë e më shpesh ipeshkvij dhe qendra të ndryshme ipeshkvore të kësaj zone, ndër to: Scodra, Dyrrachium,

6 Mihăescu 1968 129v.; 1978 17vv.

7 Mihăescu 1968 134.

8 (lat.) ...*ut ab Ierusalem per circuitum usque ad Illyricum repleverim Evangelium Christi...* (Roman. 15,19); ...*abiit ... Titus in Dalmatiam.* (2. Timotheus 4,10) = (shq.) ...*qysh prej Jerusalemit e për qark në Iliri e kam përhapur Ungjillin e Krishtit...*; ...*Titi në Dalmaci...* (Citatat lat. sipas botimit dygjuhësh gr.-lat. NESTLE-Bibel, Stuttgart 1960.; citatat shqip sipas „Shkrimi Shenjt“ – përkth. Dom Simon Filipaj).

9 Shih Koch (1989 32) që na kumton për martirizimin e Astius në Dyrrachium (98-117); të Isaurus në Apollonia; të T(h)erinos në Buthrotum (Butrint - 249-51). Shih edhe Malaj 1998 16v.

Scampa, Apolonia, Byllis, Aulona, Amantia, Hadrianopolis (Melan ?), Onchesmus (Saranda) etj.<sup>10</sup>

Përmbajtja dhe shfaqja e objekteve të ndryshme të kultit dhe artit që janë zbuluar dhe klasifikuar dëshmon gjithashtu pozicionin ndërmjetës të kësaj zone midis Perëndimit dhe Lindjes. I tillë është p.sh. prezantimi i Shën Mërisë si Mbretëreshë e Qiellit por me veshje lindore në mozaikët e murit të ruajtur në një kapelë të vogël në Durrës.<sup>11</sup>

Ngërthimi i kësaj zone në Perandorinë Romake të Lindjes (Bizant) fillimisht nuk solli me vete ndryshime në organizimin e marrëdhënieve kishtarë. E gjithë zona iu nënshtrua deri aty nga fundi i shek. VI juridiksionit të Papës së Romës, i cili vijoi të gëzojë të drejtën për të emëruar ipeshkvit e dioqezave të ndryshme, madje në vitin 591 nuk mungon të emërojë edhe si vikar të tij ipeshkvin e Selanikut, gjithsesi *pro forma*, pasi dyndja e fiseve sllave jugore në Ballkan shthuri dhe rrënoi thujtë gjithkund organizimin kishtar dhe institucionet e kultit. Të datuar janë p.sh. shkatërrimi i dioqezës së Shkodrës dhe të Doclea-s në vitin 602, ose ajo e Lezhës (Lissus) në vitin 595, ku mendohet të jenë përfutur ngulimet më të para sllave në këtë zonë. E gjithë kjo zonë sikurse krejt Ballkani përjetoi një kthim prapa drejt së ashtuquajturës jetë “pa histori” (Weithmann 1995vv.), derisa u ngjizën gradualisht marrëdhëniet e reja social-ekonomike dhe ato kulturore ndëretnike. Trojet e banuara tashmë në shumicë me sllavë të ardhur, dalloheshin nga mjedisi rrethues me një emërtim të ri tosk. *Shqeri* ~ geg. *Shki(e) ni* “Sllavoni”. Gjithsesi edhe popullsia anase në ngulimet rurale dhe në ndonjë qendër të vogël urbane, që mundi me i shpëtuar rrungajës sllave u rrek dhe gjeti strehën për të mbijetuar, duke iu përshtatur kështu rrethanave të reja në mjedisin e ri ekologjik social-kulturor. Kërkimet arkeologjike në treva të ndryshme të kësaj zone, sidomos në Shqipërinë e Veriut dhe në atë të Mesme dëshmojnë një vazhdimësi të traditës jetësore anase deri në kapërcyell të Mesjetës shqiptare.<sup>12</sup>

Një kohëzgjatje të konsiderueshme u desh të përjetojë edhe riorganizimi i Kishës si institucion kulti, i cili u desh me përvijuar tjetër drejtim në zonën në fjalë. Këtu fillojnë të fiksojnë gurët e sinorit Kisha e Lindjes (Kostandinopoja – Roma e Lindjes) dhe Kisha e Perëndimit (Roma e Perëndimit/Vatikanit). Kjo fazë përkon pak a shumë në kohë me periudhën e mirënjohur në historinë bizantine si “Lufta e ikonave” (shek. VIII – IX), pikërisht kur perandori bizantin Leo III vulosi *de jure*

10 Të dhëna të hollësishme te Malaj 1998 16v.

11 Paraqitje e hollësishme e objekteve dhe ndërtimeve të hershme sakrale-kristiane në Shqipëri te Koch 1989 33ff.

12 Këtë vazhdimësi e dëshmojnë p.sh. gërmimet në nekropolet në Koman dhe Shurdhah, me varre të pasura në objekte zbulimi dhe qeramikë të shumtë; shih Koch 1989 46.

juridiksionin e Kishës së Lindjes mbi gjithë Ballkanin (viti 726). Të gjitha ato treva, ku Bizanti mëtonte sundimin e tij, ose që me kohë mundi t'i rifitonte, kaluan nën administrimin kishtar të Kishës së Lindjes, meqë në periudhën në fjalë Kisha dhe Shteti sendërtonin një institucion. E tillë ishte p.sh. Tema e Durrësit që në shek. IX ishte shndërruar në një provincë kishtarë.

Në bashkëvajtje me zhvillimet sociale dhe politike në këtë zonë, Kisha e Lindjes vjen e fiton kështu gjithnjë e më shumë terren. Një rol të rëndësishëm në këtë periudhë luan sidomos arqipeshkvia e Ohrit, së cilës iu bashkuan shumë ipeshkvi në Jug dhe Lindje të Shqipërisë. Kështu, pas një periudhe të gjatë prej më se 5 shekujsh (shek. VII – XII) mundi të rigjallërohet një rrjet i fuqishëm institucionesh kulturi që mbulonte tërësisht hartën administrative kishtarë në të gjithë hapësirën (e sotme) kompakte shqipfolëse.<sup>13</sup>

3. Marrëdhëniet fetare dhe ato etnike që u zhvilluan në këtë zonë prej shek. XI deri në shkatërrimin përfundimtar të Perandorisë Romake të Lindjes (Bizantit – 1453) plotësojnë qerthullin problematik të krishterimit ndër shqiptarë, në fazën e parë të zhvillimit të këtij procesi.

3.a Marrëdhëniet fetare në këtë zonë kushtëzohen sikurse edhe më parë prej dukurive të ndryshme politike e kishtarë-administrative. E gjithë zona shndërrohet gradualisht në një arenë lufte midis Kishës së Lindjes dhe të Perëndimit, konfrontimi i të cilave përcolli në vitin 1054 edhe skizmën, çarjen e parë zyrtare të Krishtërimit në Evropë. Kjo trysni u ndie sidomos në Shqipërinë e Veriut dhe të Mesme, ku ushtronte ndikimin e saj të fuqishëm Kisha Perëndimore (më pas Katolike Romake) me qendër të saj në Raguza (sot Dubrovnik) dhe më vonë në Tivar (Antibari – 1080). Më vonë, pas pushtimit të Kostandinopojës prej kryqtarëve në kryqëzatën e katërt (1204), Perëndimi përforcoi praninë e vet edhe në pikëpamje politike administrative. Venediku fitoi Durrësin (1205), ku 7 dekada më pas mbreti i Napolit Karl Anjou do të shpallte *Mbretërinë e Shqipërisë* (Regnum Albaniae – 1272) me shtrirje deri në Vlorë dhe me synim të qartë, që të krijojë një rajon të çliruar prej ndikimit ortodoks grek. Megjithatë Kisha Ortodokse, e cila prej shek. XIII na shfaqet në Ballkan me një pamje trefishe, pikërisht me ane të ritit ortodoks grek, bullgar dhe serb, arriti të ruajë dhe mbrojë autonominë e vet të paktën në trevat në jug të lumit Shkumbin.

13 Në këtë periudhë dëshmohet aktiviteti i dioqezave të Durrësit (Dyrrachium), Laçit (Stephaniaka), Krujës (Albanum), Drishtit (Drivastum), Svaçit (Suacium), Pultit (Polatum), të Skampës (Scampa – zhvendosur më vonë në Vrego), Gradecit (zhvendosur më vonë Berat), Vlorës (Aulona), Glavanicës, Kunavisë (Chunavia), si edhe i dioqezave sufragane të Prizrenit dhe të Dibrës. Shih më hollësisht Meksi 1978 65vv.

Shumë domethënës në këtë drejtim është edhe mbishkrimi trigjuhësh (latinisht, greqisht dhe sllavisht) i shugurimit të Kishës së Shën Gjon Vladimirit pranë Elbasanit. Pas gjase këtu kalonte dikur edhe vija e re kufitare-konfesionale, e cila ju mbivendos kufirit të dikurshëm midis kulturave të Perëndimit dhe Lindjes (shih më lart § 2.c). Në veri të kësaj vije vepron Kisha Katolike Romake, ndërsa në jug ushtron ndikimin e vet Kisha Ortodokse Greke (dhe Bullgare).

3.b Lidhur me bashkësinë etnike shqipfolëse në këtë zonë, mund të thuhet paraprakisht që shqiptarët njiheshin si popullsi e krishterë, edhe kur përmenden për herë të parë në shek. XI. në kronikat e historisë bizantine me emrin etnik *Albanoi, Arvanitai*.<sup>14</sup> Ky emër etnik përdoret deri në fillim të shek. XIII kryesisht për banorët që jetonin në hinterlandin e temës bizantine të Durrësit, e që duhet të kenë pasur ndoshta dikur si qendër kryesore urbane qytetin e atëhershëm të Krujës. Ky qytet dëshmohet në shek. XII edhe si seli e ipeshkvit të Arbënit (*episcopus Arbanensis*). Zona vetë, e njohur me toponimin Arbën (*Arbanon*) dëshmohet në këtë periudhë (1190 – 1216) edhe si një formacion i parë i pavarur shtetëror nën sundimin e arkondit Dhimitër (Demetrios) me djemtë e tij Gjini (*Johannes*) dhe Progon (*Progonos*), e me shtrirje prej Malësisë së Krujës e Tiranës deri në zonën bregdetare në perëndim dhe në të dyja pjesët malore të lumit Shkumbin.<sup>15</sup> Në fund të shek. XIII e sidomos prej shek. XIV e këtej ky emër etnik shënon gjithkund popullsinë (pas gjase shqipfolëse) në hapësirën e sotme kompakte shqiptare, madje gjen përdorim edhe për bashkësitë (pa dyshim shqipfolëse) në Malin e Zi, në Rrafshin e Dukagjinit dhe Kosovë, si edhe për asosh që shpërngulen drejt Jugut: në Thesali, Atikë, Peloponez deri në ishujt e Egjeut.

Në qoftë se shpërnguljet arbërore drejt Greqisë janë të datuara dhe dokumentuara deri diku shterueshëm,<sup>16</sup> çështja e përhapjes fillestare e emrit etnik: geg. *arbënuer*, (i) *arbëresh*, *arbën* (?) ~ tosk.

14 "... οὐ μὴν δὲ ἀλλὰ καὶ οἱ ποτε σύμμαχοι καὶ τῆς ἰσοπολιτείας ἡμῖν συμμετέχοντες, ὡς καὶ αὐτῆς τῆς θρησκείας, Ἀλβανοὶ καὶ Λατῖνοι ὅσοι μετὰ τὴν ἔσπεριαν Ρώμην τοῖς Ἰταλικοῖς πλησιάζουσι μέρεσι, πολέμιοι παραλογώτατοι ἐχορημάτισαν ἐμπεπαρωνηκότος εἰς τὸν ἄρχοντα τούτων τοῦ τότε τὴν στρατηγίαν ἰθύνοντος Μιχαὴλ δουκὸς τοῦ Δοκειανοῦ." (Jahr 1043, S. 10: Aus der Ausgabe *Michaelis Attaliotae historia*, hg. W. Brunet überarbeitet von I. Bekker. Bonn 1853). (Përkthimi shqip: "Për fat të keq ndodhi që [pikërisht] ata njerëz që kishin qenë dikur aleatët tanë dhe bashkë me ne ndanin të njëjtat të drejta qytetare, sikurse edhe të njëjtën fe, pikërisht shqiptarët dhe të gjithë latinët, të cilët jetonin në fqinjësi në trevat italice në perëndim të Romës [mbretërisë sonë] krejt pa pritur u shndërruan në armiq, kur Michel Dokeianos si komandant suprem ... lëshoi një urdhër kundër komandantit të tyre ..."

15 Ducellier 1981 75vv.

16 Jochalas 1971 89ff.

*arbëror, arbëresh, arbër*, e së bashku me të edhe ajo e hapësirës jetike të bashkësisë shqipfolëse në atë cak kohor kur përmenden për herë të parë në historinë e shkruar të Ballkanit (shek. XI), mbetet sot për sot ende objekt i debatit shkencor albanologjik.<sup>17</sup> Lidhur me këtë çështje, e cila meriton sigurisht një studim të mëvetësishëm, po lejojmë të cek shkurt në bashkëlidhje me temën e këtij studimi, rrethanat që vijnë:

- Anëtarët e bashkësisë etnike shqipfolëse dallohen në analet historike të kësaj periudhe edhe me emra të tjerë etnikë, si p.sh.: maqedonë (*Macedones*) e sidomos epirotë (*Epirotes*), sikurse dëshmohet edhe në një letër që *Dominus Albaniae* Gjergj Kastrioti i dërgon dikur princit të Tarantos.<sup>18</sup>

- Kufijtë konfesionalë: *katolik romak ~ ortodoks (grek, sllav)* pas gjase nuk kanë luajtur fillimisht ndonjë rol të veçantë në përdorimin dhe përhapjen e këtij emri edhe pas skizmës, sikurse dëshmon edhe dokumentacioni historik (shën. 1, 14) e jo më pak emërtimet e bashkësive të diasporës shqiptare, që nuk kanë si përbërës semantik përkatësinë fetare, si p.sh. *arvanit, arbëror* tek arvanitët e Greqisë (ortodoksë grekë), *arbëresh, albresh, briesh* tek arbëreshët e Italisë (kryesisht juniadë), *arbanas* te arbëreshët e Kroacisë dhe të Sremit (katolikë romakë), apo *allbanc* te arbëreshët e Bullgarisë e të Ukrainës (ortodoksë sllavë).

- Pas gjithë gjasash, etnikoni *arbën(-)* sendërton në këtë periudhë një shtresë të caktuar sociale, pikërisht popullsinë malësore shqiptare, që dallohej në mjedisin social multi-etnik të kësaj zone me disa tipare identifikuese, si p.sh. gjuha si mjet komunikimi brenda bashkësisë, marrëdhëniet ekonomike (blektori, bujqësi malore), e drejta zakonore dhe tradita jetësore e përbashkët (doket, ritet, veshjet etj.)

- Analiza gjuhësore e formave të ndryshme dialektore geg. *arbën(-)* ~ tosk. *arbër(-)* – në bashkëlidhje edhe me toponimin *Arbanon* – lejojnë gjithashtu të deduktojmë përdorimin e këtij etnonimi në një mjedis më të gjerë gjeografik e sigurisht në një periudhë shumë më të hershme se sa caku kohor i dokumentimit të tyre të parë në kronikat bizantine të kohës (shih më poshtë)

4. Nga kjo paraqitje e thukët a) e marrëdhënieve kulturore ndëretnike të dikurshme në hapësirën e sotme kompakte shqipfolëse, përkatësisht b) e pozicionit të saj si urë lidhëse por edhe si ledh

17 Shih më hollësisht për rrethanat politike-historike, social-ekonomike dhe kulturore-fetare në historinë e popullit shqiptar si edhe emërtimeve të tij gjatë mesjetës, ndër të tjerë : Stadtmüller 1966 160vv.; Çabej 1976 61vv.; Frashëri 1985 207vv. ; Schmitt 2001 45vv. e së fundi Xhufi 2006 3vv.;

18 Radonić 1942 129: "Se le nostre croniche non mentono, noy ci chiamano Epiroti." (31 dhjetor 1460).

ndarës midis kulturash atëbotë globale të antikitetit dhe të mesjetës në Evropë; si edhe b) e ecurisë që përjetoi procesi i kristianizimit së bashku me organizimin e Kishës si institucion kulturi; arritëm së paku të qëmtojmë disa pika orientuese, të cilat mundësojnë tani të ndjekim me pak a shumë siguri fillimet e misionimit dhe zhvillimet që përjetoi procesi i kristianizimit në bashkësinë kulturore-etnike shqipfolëse gjatë periudhës para hyrjes së tyre në historinë e shkruar të Evropës. Brenda këtij kuadri feks gjithnjë e më dallueshëm rëndësia që fiton pikërisht përpunimi filologjik-gjuhësor i trashëgimisë kulturore të shkrimit shqip dhe i terminologjisë popullore kristiane. Dhe arsyetimi për këtë është i thjeshtë: dokumentimi historik i këtij procesi deri në shek. XI lidhet kryekëput me zonën, e cila përkon në kohën tonë me hapësirën jetike të shqiptarëve, pra jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me bashkësinë shqipfolëse për periudhën në shqyrtim. Çështja duket sikur hyn në një rreth vicioz, i cili nuk premtion zgjidhje. Në fakt një zgjidhje alternative nuk mungon. E kjo ka të bëjë me shqyrtimin e problemit për nga perspektiva e etnolinguistikës, më konkretisht: me studimin e fondit të leksikut terminologjik kristian në gjuhën shqipe, përkatësisht me krehjen dhe sistematizimin e tij në shtresa leksikore në bashkëvajtje me saktësimin e kronologjisë dhe të burimit gjuhësor përkatës. Kjo metodë studimi lejon të rindërtojmë në vija të përgjithshme procesin e misionimit dhe të kristianizimit të shqiptarëve duke përfshirë këtu kohën, hapësirën dhe rrethanat kur ka vepruar në vazhdimësi ky proces ndër shqiptarë deri në shfaqjen e tyre në historinë e Ballkanit (shek. XI).<sup>19</sup>

Në rast se në vazhdim do të merremi kryesisht me fondin e leksikut terminologjik kristian në gjuhën shqipe, është më se e kuptueshme që kjo ndërmarrje të kufizohet vetëm në hetimin e atyre njësive leksikore, të cilat janë pjesë e ligjërit të thjeshtë popullor, e që ky është thithur e përdorur si i tillë edhe në shqipen letrare kishtarë të teksteve të vjetra shqipe në shek. XVI-XVIII. Pra nuk do të merren këtu parasysh terma dhe njësi leksikore me karakter diturak që dalin (me shumicë) në këto shkrime. Shumë instruktiv paraqitet në këtë pikë edhe saktësimi, nëse kjo apo ajo njësi që merret në analizë përdoret pa dallim apo është pronë e fondit terminologjik kishtar vetëm e një konfesionit.

Njohja dhe zbatimi i këtyre kriterëve metodike lejon tashmë të dallojmë me saktësi disa shtresa leksikore në terminologjinë popullore kristiane të gjuhës shqipe:

4.a Termat kishtarë të burimit latin ngërthejnë shtresën më të vjetër, e cila del thuasht me të njëjtën dënduri dhe gjithkund në letërsinë e

<sup>19</sup> Kjo gjetje dhe procedurë metodike është e mirënjohur në hetimin e fillimeve të misionimit kristian ndër popujt e tjerë të Evropës, p.sh. të gjermanëve.

vjetër shqipe të shek. XVI-XVIII pavarësisht nga ngjyra konfesionale: katolike-romake apo ortodokse. Për më tepër kjo shtresë ndërthun termat dhe nocione bazë që i kanë të përbashkëta variantet e gjuhës kishtare në të dyja konfesionet. Përmendim këtu: *bekoj* < *benedicō*; *dreq* < *dracō*; *engjëll* < *angelus*; *ferr* < *infernum*; *kreshmë* < *quadragēssima*, *Krisht* < *Christus*; (t.) *këngë* ~ (g.) *kangë* < *canticum*; (dial. t.) *i krishterë*, (g.) *i krështenë*; *i kërshten* < *christianus*, *kryq*, (dial. t., arb. Gr./it.) *kriq* < *crux*, *-cis*; *kungoj*, (Matrënga) *kunkonj* < *communicō*; *lter* < *altare*; (t.) *ngjëroj*, *a(n) gjëroj*, (g.) *ngjënoj*, *ngjinoj* < *iēiūnō*, *mallkoj* < *maledicō*, *m(ë)kat* < *peccātum*; (t.) *murg*, (g.) *mun(ë)g* < *monac(h)us*; *Pashkë* < *Pascha*; *prift* < *pre(s)byter*; (t., g.) *qelq*, *kelq* < *calix*, *-icis*; *Shenjti*, *i shenjhtë* < *sānctus*; *shpirt*, *Shpirti i Shenjtë* < *spīritus* (*sānctus*); *shërbej* < *servō*; *ungjill* < *evangelium* etj.<sup>20</sup>

Kjo shtresë shtrihet në kohë në një periudhë që shkon deri në shek. VI-VII (romaniteti ballkanik). Po të mbajmë parasysh sjelljen gramatikore të huazimeve më të vjetra latine në gjuhën shqipe, mund të vijmë pa ngurrim në përfundimin, se kemi të bëjmë me huazime të një periudhe të mëvonshme të ndikimit latin mbi shqipen, pikërisht në një kohë kur latinishtja e kishte bjerrë gjininë asnjë në sistemin e saj emëror, khs. *m(ë)kat*, *-i* : lat. *peccatum*, kundrejt (dial. t.) *dëm.-të*, (dial. g.) *dam,-t* : lat. *damnum*.<sup>21</sup>

Vazhdimësia e ndikimit të latinishtes kishtare në shqipen e kohës dëshmohet mirëfilli në sjelljen e shumë fjalëtermave kristianë në shqipe, duke dëshmuar hyrjen e tyre para ndarjes dialektore së shqipes në dy dialekte: toskërishte dhe gegënishte (shek. VI-VIII). I tillë është p.sh. rasti i një numri latinizmash, si: (t.) *(i) krishterë*, (Matranga) *(i) krështe*, *kreshmë*, *lavd*, *lavdi*, (Matranga) *lëvdi* (< *laude-*), *qelq*, *bekoj*, *kryq*, *mallkoj*, *meshë* etj., të cilat mund dhe duhet të kenë depërtuar në shqipe në shekujt IV-VI.<sup>22</sup>

20 Më hollësisht Çabej SGJ IV 260v., 274vv.; Haarmann 1972 105vv.; Sh. Demiraj 1988 109vv., 1999 107vv.

21 Më hollësisht Ölberg 1995 8.

22 Kemi të bëjmë këtu me dukuri të ndryshme tingullore, të cilat kanë vepruar rregullisht në faza të caktuara të zhvillimit gjuhësor, si p.sh.: metafoia *\*-a-* → *-e-* (para *\*-i-* ose *\*-i-* në rrokjen ndjekëse); thyerja *\*-e-* → *-i-* (para *\*-s-* = <sh>); ngritja *\*-i-* → *-e-* (para *\*-a-* ose *\*-ā-* në rrokjen ndjekëse); ruajtja e tiparit [+velar] e lat. *\*(-)k(-)* (= <(-)c(-)>) (para një zanoreje të parme *\*e* ose *\*i*), përkatësisht qiellzorëzimi i saj në [c] (= <ç>) në këtë pozicion; qiellzorëzimi i zanoreve të prapme (para një bashkëtingëlloreje qiellzore burimore ose të qiellzorëzuar); refleksi i diftongut latin *-au-* > shq. *-af-* (para një bashkëtingëlloreje mbylltore); bjerja e mbylltoreve të zëshme në pozicion ndërmjet dy zanoreve; apo velarizimi lëngëtores *-l-* > *-l-* (= <ll>) në pozicion midis dy zanoreve. Rotacizimi i hundores *-n-* > (t.) *-r-* në zanafillë në pozicion midis dy zanoreve është një dukuri me përhapje dialektore, që vepron në një periudhë midis shek. VI-VIII në toskërishte. Shndërrimi *\*(-)s-* > *\*(-)š-* (deri aty nga fundi i mijëvjeçarit të parë AD) ka përfshirë edhe shtresën e vjetër të huazimeve italiane dhe sllavo-jugore në shqipe. Më hollësisht për kronologjinë relative dhe absolute të këtyre dukurive tingullore si edhe për praninë e tyre në shtresat e huazimeve lek-

Të lashta janë gjithashtu një numër kompozitash të tipit: (t., g.) *Kërshëndella*, *Kërsh-nella* "Krishtlindjet" < *Christi natāle* (që nuk ka vazhdimësi në asnjë ndër gjuhët romane); (t., g.) *Shendërtat*, *Shëndërtat* "Trini" < *Sancta Trinitate*; (g.) *këlshejt* "kupa e shenjtë" < *calice- sānctu- etj.* (Çabej SGJ IV 260v., 274vv.).

Duan mbajtur parasysh këtu edhe emrat e shumë shenjtorëve që kanë dhe janë të përhapura në shqipen popullore kryesisht të Veriut, sikurse edhe në gjuhën kishtarë të Kishës Katolike Romake, si psh.: *Pal* < *Paulus*, *Gjergj* < *Georg*, *Gjon* < *Johannes* etj. Këto forma dëshmojnë rregullisht në folklorin dhe letërsinë e vjetër ortodokse shqipe të Jugut, duke përfshirë këtu edhe trashëgiminë arbëreshe të Greqisë dhe të Italisë. Ndërsa në kohën tonë në këto treva shfaqen forma të mëvonshme që të kujtojnë gjegjëset në greqishten moderne, khs.: *Paoli*, *Jorgo*, *Jovan* etj.<sup>23</sup>

4.b Një vazhdimësi të ndikimit perëndimor që shkon deri në mesjetën e vonë dëshmon terminologjia kristiane me burim roman, italian (të vjetër - venecian) apo dalmatin, e cila ka zënë vend tashmë kryesisht në liturgjinë e ritit katolik-romak si edhe sot në ligjërimin popullor të shtresës katolike në Shqipërinë e Veriut, khs. *abat* < *abate*, *abaci* < *abbazia*; *altar* < *altare*; (*i*) *amëshuom* < *immenso*; *frat* < *frate*; *krezmë*, *krizmë* < *cresima*; *predikoj* < *predico*; *sakrament* < *sacramento*; *rruzare* < *rosario*, *Rrëshaja* < *rosalia* etj.<sup>24</sup>

Huazime të tjera, si p.sh.: (dial.) *balshëm* "vaji i bekuar" < (rom.-it. vj.) *balsamo*; *lëmoshë* < (rom.-it.vj.) *elemosina*; (t.) *këmborë*, (g.) *kum(b)onë* < (rom.-dalm.vj., khs. veql. *campuona* < lat. *campāna*), lejojnë të datohen me anë të kriterëve gjuhësorë në një periudhë që i paraprin kapërcyellit të mijëvjeçarit të parë (pas gjase një pjesë aty rreth shek. VIII-IX), shi në një kohë kur shndërrimi \*(-)s- → *sh* sikurse edhe dukuria dialektore e rotacizmit -n- > -r- ishin ende aktive në gjuhën shqipe përkatësisht në dialektin toskë.

4.c. Vend të konsiderueshëm në terminologjinë e krishterë të shqipes zë edhe shtresa e huazimeve prej greqishtes së mesme dhe të re, të cilat janë në përdorim kryekëput në variantin e gjuhës kishtarë ortodokse. Këto huazime kanë hyrë në gjuhë – me ndonjë përjashtim – në një periudhë që përkon me mijëvjeçarin e dytë. Mund të përmendim këtu disa shembuj të përzgjedhur nga katekizmi i Matrangës ("Doktrina e Krështerë", Romë 1592), të tillë si: *elejmosin* "lëmoshë" < ἐλεημοσίνη; (forma e pëngjitur) *Heredhespinë* "salve regina, Falemi Mëri (lutje)"

sikore në shqipe shih Çabej SGJ III passim; Janson 1986 189ff.; Sh. Demiraj 1996 *passim*; B. Demiraj 1997 41vv.

23 Studim i detajuar nga Sh. Demiraj 1999 110vv.

24 Meyer 1891 *passim*; Helbig 1903 110vv.; Sh. Demiraj 1988 117vv.



< χαίρε δέσποινα; *lethtrose* "shëlbohem, çlirohem (nga mëkati)" < ἐλευθερώνω "çliroj" (prej mb. ἐλεύθερος); *mirosënj* "krezmoj, jap krezmën" < μυρώνω; *Paterimonë* (krahas *Tënëzonë*) „Pater noster; Ati Ynë" < πατηρημών; *pneumatikó* (krahas *prift*) "prift; rrëfyes" < πνευματικός; *porní* "tundim" < πορνεία; *triadhë* "trini" < τριάδα, -ας; *vlavie* "përshpirtje" < εὐλάβεια etj.<sup>25</sup>

Gjithsesi shtresën më të vjetër të terminologjisë së krishterë me origjinë greke e ndeshim jo rrallë edhe në letërsinë e shek. XVI-XVII në arealin e Veriut katolik-romak, khs. (t.) *kllogjër* (g.) *kllogjën* "murg ortodoks" < καλόγερος, (t./arb. It.) *monoshtir*, (g./Budi) *munështir* "manastir" < μοναστήρι, (g.) *djemën* (sh.) „djall; demon" < δαίμονας; (t., g.) *fli, flije*, (dial.) *fëli* "pogaçe me miell e vaj" < εὐλογία "bekim; bukë e bekuar". Struktura e gjithë këtyre njësive leksikore me shndërrimet tingullore përkatëse lejon që t'i vendosim ato në një shtresë të huazimeve greke të shqipes që i takon periudhës para fundit të mijëvjeçarit të parë. E tillë është p.sh. edhe (dial. t.) *korë* "ikonë", krahas së mëvonshmes (t., g./Budi) *ikonë* < (εἰ)κόνα, e cila dëshmon dukurinë e rotacizimit të hundores -n- ndërzanore në dialektin toskë dhe si e tillë i takon një periudhe huazimi që shkon deri në shek. VIII-IX, pikërisht në periudhën e së ashtuquajturës "luftë e ikonave" (shih § 2.d).

4/d Një vend të veçantë në terminologjinë e krishterë zë edhe fondi i leksikut autokton të shqipes. Ky fond na ofron material me vlerë, sa i përket hetimit të fazave të hershme të misionimit të bashkësisë shqipfolëse, pikërisht në kohën kur të parët e shqiptarëve përqaftuan besimin kristian, përkatësisht u shkëputën prej atij të mëparshëm pagan. I tillë është p.sh. shenjuesi *Zot*,<sup>26</sup> i cili në kohët pagane shënonte "Babazotin; Sunduesin e Qiellit". Në periudhën e kristianizimit të bashkësisë shqipfolëse ky emërtim ndërron funksion duke shënuar sipas rastit Atin e jo rrallë vetë Krishtin, birin e tij, ndërsa shenjuesi mocional *Zonjë* personifikon *Shënmërinë*, Maria-n, nënën e Krishtit. Emri *hir* "bukuri, hijeshi"<sup>27</sup> përcjell ndërkohë konceptin kristian për "gratia", ndërsa mbiemri (*i*) *lumë* përdoret për "beatius". Në këtë hulli hyjnë edhe ndërtimet kompozicionale (tashmë) popullore e mbarëshqiptare: si *Imzot, Ynzot* (kall.) *Tënëzonë*, apo *hirplotë*, që pasqyrojnë modelet latine të *pater noster, gratiā plēna* sipas sintaksës së vjetër shqipe.

<sup>25</sup> Një listë deri diku e hollësishme e huazimeve prej greqishtes së re dhe të mesme në terminologjinë kishare (ortodokse) të shqipes mund të nxirret prej studimit të Uhlisch 1964 58f.

<sup>26</sup> Shih Demiraj 1997 431: pshq. \*d̥jē(ɥ)- at(t)a- „ati i qiellit“.

<sup>27</sup> Shih Demiraj 1997 201f.: huazim ose me të njëjtin burim me gr. vj. (eol.) ἱρός, (sonst) ἱερός "i shenjtë".

Në kalendarin javor të shqipes kemi ditën (e) *shtunë*, më parë (Buzuku etj.) *e shëtunde*, e cila dikur shënonte dikur pa dyshim \*\*"ditën e shtatë të javës",<sup>28</sup> ditën e pushimit, ditën e Zotit, shi ditën e *Sabbat-it* (të judejvet), por që me kohë erdhi e ndryshoi funksion, duke shënuar "ditën e gjashtë të javës" ashtu siç e kemi sot e gjithë ditën, njëlloj si në latinishte, greqishte dhe gjuhët e tjera të Ballkanit.<sup>29</sup>

4.e Edhe pse në fqinjësi shumëshekullore, në një mjedis të përbashkët kulturor-social e në marrëdhënie të ndërsjella gjuhësore, terminologjia kristiane e shqipes nuk është prekur prej ndikimit të ortodoksisë sllave. Këtë mungesë e dëshmon si ligjërimi popullor ashtu edhe trashëgimia e kulturës së shkrimit shqip gjatë shek. XVI-XVII.<sup>30</sup> Nuk kanë munguar deri sot as përpjekjet për të shpjeguar këtë situatë disi "të pazakonshme", duke marrë parasysh këtu bashkëveprimin e një numri faktorësh, të cilët në fakt nxitën procesin e kristianizimit të popujve sllavojugorë (shek. IX), por që në të njëjtën kohë kundërvepruan edhe ndaj rrezikut të asimilimit sllav që ka kërcënuar gjithherë bashkësitë shqipfolëse fqinjë.<sup>31</sup> Për zgjidhjen e kësaj enigme besojmë se shërben si pikë orientuese shtresa e hershme dhe solide e fondit latin dhe anas në terminologjinë kristiane të ligjërimin popullor të shqipes, e cila i paraprin pa dyshim në kohë procesit të misionimit e të kristianizimit të popujve sllavë në Ballkan. Parë nga ky këndvështrim lejohemi tash të mëtojmë mendimin tonë se besimi kristian ndër shqiptarë e bashkë me të organizimi kishtar dhe ushtrimi i liturgjisë kristiane mund të kenë pësuar vërtet goditje të forta negative në trevat shqipfolëse gjatë dyndjeve të sllavëve të jugut në Ballkan (Stadtmüller: shih § 1.b), megjithatë ai mundi jo vetëm të mbijetonte, por ishte shndërruar ndërkohë në një faktor identifikues kryesor në matriksin e kulturës etnike shqiptare.<sup>32</sup>

Konstelacioni i përbërësve të tjerë etnikë e sidomos përkatësia e ndryshme fetare, përkatësisht konfesionale kanë rregullar – shpesh duke ndërndërruar vendet – bashkëjetesën shumëshekullore midis shqiptarëve dhe sllavëve të jugut. Për të ardhur në këtë përfundim ndihmon edhe analiza gjuhësore e etnonimeve (t.) *arbër(-)* ~ (g.) *arbën* „shqiptar“ dhe *shqa* „sllav i jugut; serb; bullgar; malazias“. Format sllave

28 Pas gjase një kompozitë e hershme në shqipe \*sept-o- [+ dite] \*\*"dita e shtatë".

29 Khs. Buck 1949 1007: lat. *sabbatum* ose agr. *σάββατον*. Pas gjase, të paktën edhe një ditë tjetër e javës shqiptare ka në bazë një koncept kristian: (e) *premtë* < \**prami dite* \*\*"mbrëmja (e ditës) në prag të ditës së pushimit/të Zotit".

30 Për huazime „rastësore“ sllave me moshë të re e me përhapje të kufizuar dialektore shih së fundi Svane 1992 208vv.; Ylli 1997 315.

31 Shih Svane 1992 4vv., 208.

32 Mendime dhe teza të ndryshme te Stadtmüller 1954 216vv.; Schramm 1994 140vv.; Çabej SCJ IV 261; shih edhe Bartl 1993 588v.

popullore që dëshmojnë një metatezë (të likuides) të rrokjes së parë: serb.vj. (top.) *Rab̄nrb, R̄b̄nanija, Rabanija* "Arbanon", (top) *Rbana*, krahas *rabanski, rab̄n̄nski* "shqip" dëshmojnë qartë se emri etnik i shqiptarëve dhe vendbanimi i tyre kryesor *Arbanon* ishte i njohur prej kohësh ndër fqinjët sllavo-jugorë, së paku dy shekuj përpara se shqiptarët të përmendeshin për herë të parë në histori si bashkësi etnike kristiane.<sup>33</sup>

Emri etnik *shqa* me shumësinë e varianteve dialektore (më e hershme *shkla*, si edhe *shkjak; shka*) si edhe me format e metafonizuara të shumësit *shqe* (prë *shkle shkjel/shkije shke/shkij*) ka hyrë në shqipe pa dyshim nëpërmjet lat. *sclavus*,<sup>34</sup> fillimisht me tri përbërës semantikë: a) si emër me kuptim përmbledhës për një pjesëtar çfarëdo të tribuve sllave-jugore që u dyndën dhe u përhapën në Ballkan në shek. VI-VII; në bashkëlidhje me këtë b) "pagan" në kuptimin "jo-kristian"; e më vonë i kombinuar edhe me kuptimin c) "skllav" si një "person pa të drejta dhe pa plang" (shek. IX – XI).<sup>35</sup> Të tre këta përbërës semantikë, në rrjedhë të kohës e në përputhje me ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore dhe kulturore-fetare, i janë nënshtruar në gjuhën popullore ku më shumë e ku më pak ndryshimit kuptimor. Kështu për shembull vjen e rrëgjohet gjithnjë e më shumë përbërësi kuptimor i dikurshëm për "skllav", i cili dëshmohet në kohën tonë vetëm si relikto gjuhësor me kuptimin derivat "shërbëtor".<sup>36</sup> Përdorimi me kuptimin përmbledhës për një person me origjinë sllave-jugore ndërndërrohet vazhdimisht me banorin fqinj që i përket etnisë sllave malazeze, serbe ose maqedone-bullgare në varësi kjo me fqinjësinë gjeografike-gjuhësore si edhe në bashkëlidhje me zhvillimet sociale-historike të vetë rajonit; khs. *shqa = malazez, cërnağoras ~ serb ~ maqedon/bullgar*. Përdorimi i dikurshëm i *shqa* edhe me kuptimin "pagan; jo i krishterë", i cili nxori jashtë përdorimit në terminologjinë popullore kristiane shenjuesin e mëhershëm (t.) (*i pëgërë*, (g.) *i pëgā* mb. "i papastër, i fëlliqur" (< "pagan, jo i krishterë" < lat. kisht. *pāgānus*)<sup>37</sup>, erdhi dhe u përdor me kohë, sipas përkatësisë konfesionale ose fetare, me kuptimin "skizmatik, ortodoks; pjesëtar i kishës ortodokse bullgare, përkatësisht serbe" madje edhe me konotacion negativ si "heretik".<sup>38</sup> Ky përbërës i ri kuptimor, që është

33 Lidhur me kronologjinë e metatezës së likuideve në sllavishten e jugut (shek. IX) shih ndër të tjerë Bräuer 1961 79vv.

34 Meyer 1891 410.

35 Korth 1970 151f.

36 Khs. proverbin: *më mundo si shkjanë e më duaj si vëllanë* "kështu i thotë kali të zotit, d.m.th.: më detyro të punoj sa të duash, por më jep të ha mirë." (Leotti 1937 1370). Shih edhe Kristoforidhi 1961 339.

37 Më hollësisht për këtë tek B. Demiraj 2002 23vv.

38 Shih ndër të tjerë: Hahn 1854 120; Bashkimi-Shoq. 1909 424; Leotti 1935 1406; Mann 1948 494.

përdorur gjerësisht sidomos në letërsinë fetare të arealit kulturor katolik të Veriut, duket të jetë një zhvillim i brendshëm i shqipes, pasi nuk ka një gjegjës përkatës në terminologjinë kishtare të vendeve të krishtera (ballkanike).<sup>39</sup>

Shndërrime semantike bëhen gjithnjë e më largvajtëse, në rast se marrim në analizë trevat jugore të hapësirës kompakte shqipfolëse në Ballkan si edhe diasporën shqiptare në Greqi e në Italinë e Jugut. Kështu do të vërejmë se në trevat e Jugut ky etnikon a) ose është bjerrë tërësisht<sup>40</sup>; b) ose komponenti etnik-gjuhësor "sllav (i jugut)" së bashku me derivatet e veta është zëvendësuar me komponentin etnik-gjuhësor "grek, jo-arvanit" në diasporën arvanite të Greqisë; përkatësisht me atë "jo-arbëresh" në diasporën arbëreshe në Italinë e Jugut, khs. (arb. Gr.) *shkla* "grek një gjuhësh, jo-arvanitit", *shklërisht*, *sklërisht* "greqisht", ose (arb. It) *shklan* "që nuk kuptohet, që nuk flet arbërisht", *shklërisht*, *shqarisht* "(flet) jo qartë, jo arbërisht". Sigurisht që kjo situatë "e pazakonshme" nuk paraqet vështirësi shpjegimi, në rast se marrim parasysh që shenjuesi *shqa* ndër shqiptarë, të paktën në periudhën para shpërnguljeve arvanite drejt jugut të Greqisë dhe Peloponezit (shek. XIII), përballej ndërkohë me një ridimensionim konceptual, duke dalluar pikërisht "fqinj (tjetër)", d.m.th. jo-shqiptarin.<sup>41</sup>

5. Në mbyllje të kësaj parashtrëse të thukët lejohemi të ritheksojmë se analiza e fakteve gjuhësore që ofron terminologjia e krishterë në ligjërimin popullor si edhe në letërsinë e vjetër shqipe tumir dhe përforcon mendimin, sipas të cilit fillimet e misionimit kristian e të vetë kristianizimit të bashkësisë etnike shqipfolëse në Ballkan duan kërkuar në periudhën e antikitetit të vonë (shek. IV – V AD). Shtresa më e lashtë leksikore që përbën edhe sot bazën e terminologjisë kristiane në shqipen kishtare, kufizon në kohë me periudhën e hershme të ndikimit bizantin (deri aty rreth shek. VIII) dhe është thujse krejtësisht e burimit latin (të vonë e mesjetar) e në një masë të konsiderueshme edhe e burimit anas të shqipes. Kjo rrethanë lejon të mbështesim natyrshëm mendimin që procesi i kristianizimit të shqiptarëve u zhvillua nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e Kishës Romake të Perëndimit. Këtij përfundimi i vjen për shtat edhe dokumentacioni kishtar, i cili na kumton që hapësira e sotme kompakte shqipfolëse, të paktën deri në gjysmë e parë të shek. VIII mbetej nën juridiksionin e Papës së Romës dhe kishte në përdorim

39 Shih B. Demiraj 2006/7 406vv.

40 Gjurmët që ndeshim këtu janë të rralla dhe hyjnë kryesisht në nomenklaturën e kodit të nderit në jetën zakonore shqiptare. I tillë është p.sh. ndërtimi mocional (çam.) *shklirë* që dallon "një femër e përdalë, femër që kryen marrëdhënie seksuale jashtë martesë" \*(= femër që jeton jashtë normave të traditës zakonore shqiptare). Më hollësisht te B. Demiraj 2006/7 406vv.

41 Më hollësisht Demiraj 2006/7 406vv.

zyrtar latinishten. Në periudhën e dyndjeve të popullsive sllave në Ballkan, pikërisht në një kohë kur u kërcënua seriozisht zberthimi i etnogjenezës shqiptare, kristianizimi i shqiptarëve na paraqitet si një proces i përfunduar, ndërsa vetë përkatësia fetare kristiane u shndërrua – krahas njësisë gjuhësore – në një ndër faktorët identifikues kryesorë në kulturën e tyre etnike. Shtresa më e re e terminologjisë kristiane e shqipes datohet në shek. VIII – XVI/XVII, dhe është për nga burimi i saj heterogjen, duke dëshmuar kështu më së miri një prirje drejt degëzimit, e kushtëzuar kjo nga gjeografia kishtarë e vetë zonës në fjalë, fati i së cilës ishte prerë ndërkohë: asaj i duhej të përjetonte dhe të përcillte në mish e në shpirt pasojat e shkundullimës që ra midis Romës dhe Kostandinopojës.

### Abstract

Taking in consideration the source where their conversion sprang from, this ethnolinguistic study attempts to trace back in time and space the beginnings of Christianity among the Albanians. Initially Prof. Demiraj introduces the geographical configuration of Western Balkan; the historical and social situation of the Albanian community; Eastern and Western cultural influences on the Albanians, as well as the administrative organization of the Church in the early Middle Ages until the great schism (1094 AD).

Then the essay focuses on the analysis of the most prominent linguistic evidence of Christian terminology in both earliest written and currently spoken Albanian. These facts seem to bolster the theory that the conversion of the Albanians dates back to Late Antiquity (4<sup>th</sup> and 5<sup>th</sup> century AD)

## Literaturë e përzgjedhur<sup>42</sup>

- Banfi, E.: *Cristianizzazione nei Balcani e formazione della lega linguistica balcanica*, në: "Zeitschrift für Balkanologie" 23 [1987] 4-18.
- Blanchus, F.: *Dictionarum latino-epiroticum*, Rom 1635 (bot. kritik: Shkodër 2008 – botues B. Demiraj).
- Bartl, P. & Camaj, M.: Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689", në: "Zeitschrift für Balkanologie" 5 [1967] 23-33.
- Bartl, P.: *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeit (1878-1992)*. Wiesbaden 1968.
- Bartl, P.: *Religionsgemeinschaften und Kirchen*, në: *Albanien*, në serinë „Südosteuropa-Handbuch“, bl. VII, Göttingen 1993.
- Bashkimi-Shoq.: *Fjaluer i Rii i Shcypës. Përbâam Préie Shocniët Bashkimit*. Shkodër 1908 (bot. II: Prishtinë 1978).
- Bogdani, P.: *Cuneus Prophetarum de Christo Salvatore Mundi et eius evangelica veritate*, Padua 1685. (bot. anastatik: *Cuneus Prophetarum a Pietro Bogdano*, në serinë: „Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Ostens“ Bd. XXIV, München 1977 – botues G. Valentini - M. Camaj).
- Bräuer, H.: *Slawische Sprachwissenschaft*, bl. I (Einleitung und Lautlehre), Berlin 1961.
- Buck, C. D.: *A Dictionary of Selected Synonyms in the Principal Indo-European Languages*, Chicago & London 1949.
- Budi, P.: *Dottrina Christiana*, Romæ 1618.
- Budi, P.: *Rituale Romanum*, Romæ 1621.
- Budi, P.: *Speculum Confessionis*, Romæ 1621.
- Buzuku, Gj.: *Missale*. 1955 (bot. kritik: *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano 1958 – botues N. Resuli).
- Çabej, E.: *Studime Gjuhësore*, bl. I-VI, Prishtinë (1976-77).
- Demiraj, B.: *Albanische Etymologien. Untersuchungen zum altererbten Wortschatz*, në serinë: „Leiden Studies in Indo-European“, bl. VII, Atlanta-Amsterdam 1997.
- Demiraj, B.: „Der Slawe“, shqau, im Albanischen. Eine ethnolinguistische Fallstudie zu Herkunft und Aussagekraft einer Fremdbezeichnung, në: "Südost-Forschungen" 65/66 [2006/2007] 406-421.
- Demiraj, Sh.: *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988.
- Demiraj, Sh.: *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1996.
- Demiraj, Sh.: *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, Tiranë 1999.

<sup>42</sup> Bibliografia e punimit e kapërcen në pak raste cakun kohor të mijëvjeçarit të ri, pikërisht kur ky studim u botua në formë më të përmbledhur në gjermanisht me titull: *Einheitlichkeit und Spaltung im Laufe des Christianisierungsprozesses der Albaner. Eine ethnolinguistische Fallstudie*, në: „Studime“ 2001/2 f. 23 – 41, Prishtinë.

- Ducellier, A. : *La façade maritime de l'Albanie au Moyen Âge. Durazzo et Valona du XI<sup>e</sup> au XV<sup>e</sup> siècle*. Saloniki 1981.
- Ducellier, A. : *L'Albanie entre Byzance et Venise, Xe - XVe siècles*, London 1987.
- Elsie, R.: *Albania in the "Anonymi Descriptio Europae Orientalis" (1308 A.D.)*. in: "Zeitschrift für Balkanologie", Berlin, 26.1 (1990), p. 24-28.
- Frashëri, K.: *The territories of the Albanians in the 15<sup>th</sup> century*, in: *The Albanians and Their Territories*, Tiranë 1985.
- Guzzetta, Giorgio: *L'osservanza del rito preso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa (= titulli i origjinalit në dorëshkrim: De Albanesium Italiae ritibus excolendis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint)*, Palermo 2007.
- Haarmann, H.: *Der lateinische Lehnwortschatz im Albanischen*, në serinë Serinë „Hamburger philologische Studien“ bl. XIX, Hamburg 1972.
- Hahn, J.G. v.: *Albanesische Studien*, Heft III, Wien 1854.
- Helbig, R.: *Die italienischen Elemente im Albanischen*, Leipzig 1903.
- Hetzer, A.: *Geschichte des Buchhandels in Albanien*, në serinë: „Balkanologische Veröffentlichungen“, bl. X, Berlin 1985.
- Janson, B.: *Etymologische und chronologische Untersuchungen zu den Bedingungen des Rhotazismus im Albanischen unter Berücksichtigung der griech. und lat. Lehnwörter*, në serinë: „Studien zur klassischen Philologie“ bl. 21, Frankfurt am Main - Bern - New York 1986.
- Jochalas, T.: *Über die Einwanderung der Albaner in Griechenland (eine zusammenfassende Betrachtung)*, në: „Dissertationes albanicae“ 17 [1971] 89-106.
- Jokl, N.: *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*. Berlin und Leipzig 1923.
- Kamsi, V.: *Gjon Buzuku e Konzili i Trentit*, in: „Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare“, Tiranë 1995, S. 381-388.
- Koch, G.: *Albanien. Kunst und Kultur im Land der Skipetaren*, Köln 1989.
- Korth, G. v.: *Zur Etymologie des Wortes „Slavus“ (Sklave)*, in: „Glotta“ 48 [1970], S. 145-53.
- Kristoforidhi, K: *Fjalor shqip-greqisht* (bot. II – botues A. Xhuvani), Tiranë 1961.
- Leotti, A.: *Dizionario albanese-italiano*, Roma.
- Malaj. V. P.: *Kuvendi i arbënit 1703*, Prishtinë 1998.
- Mann, S. E.: *An Historical Albanian-English Dictionary*, London - New York - Toronto 1935.
- Matrënga, L.: *E mbsuame e chraesterae*, Romæ 1592 (ribotim: F. Sulejmani: *E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës*, Prishtinë 1979).
- Meyer, G.: *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Straßburg 1891.

- Mihăescu, H.: *Die lateinische Sprache in Südosteuropa*, në: „Zeitschrift für Balkanologie“ 6 [1968] 128-136.
- Mihăescu, H.: *La langue latine dans le sud-est de l'Europe*. București 1978.
- Mirdita, Z.: *Krishtënizimi ndër shqiptarë*, Prizren – Zagreb 1998.
- Ölberg, H.: *Die ursprünglichen Wohnsitze der Albaner auf der Balkanhalbinsel*, në: „Dardania“ 4 [1995] 8.
- J. Radonić, *Đurađ Kastrioti-Skanderbeg*, Belgrad 1942
- Reinhold, Th.: *Noctes pelasgicae*, Athenis 1954 (pjesa: *Lexikon*)
- Roques, M.: *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris 1855.
- Schmitt, O. J. : *Das venezianische Albanien (1392 – 1479)*, në serinë: „Südosteuropäische Arbeiten“, Nr. 110, München 2001.
- Schramm, G.: *Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Besen und ihre langen Folgen*, Freiburg im Breisgau 1994.
- Stadtmüller, G.: *Altheidnischer Volksglaube und Christianisierung in Albanien*, në: „Orientalia Christiana Periodica“ 20 [1954] 211-46.
- Stadtmüller, G.: *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, në serinë: „Albanische Forschungen“ bl. 2, Wiesbaden 1966.
- Svane, G.: *Slavische Lehnwörter im Albanischen*, në serinë: „Acta Jutlandica LXVIII. Humanistische Reihe“ bl. 67, Aarhus 1992.
- Uhlisch, G.: *Neugriechische Lehnwörter im Albanischen*, Leipzig 1964 (Disertacion – dsh. 258 f.).
- Vogel, F. J.: *Rom und die Ostkirchen*. Aschaffenburg 1961 (bot. II).
- Weithmann, M.: *Balkan Chronik* (2. aktualisierte und erweiterte Auflage), Darmstadt 1997.
- Xhufi, P.: *Dilemat e Arbërit*, Tiranë 2006.
- Ylli, Xh.: *Das slavische Lehngut im Albanischen*, 1. Teil, në serinë: „Slavistische Beiträge“ bl. 350, München 1997.
- Zeitler, W.: *Das lateinische Erbe im Albanischen und die älteren Wohnsitze der Albaner*, në: „Zeitschrift für Balkanologie“ 14 [1978] 200-208.